

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFQISHËM  
 PËR TËRË VËNDSHMATA  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUB  
 FERIZAJ I UKOŠEVAC

## NË EMËR TË POPULLIT

28.09.17 GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm –

Divizioni Penal, gjyqtari individual Mustaf Tahiri, me procesmbajtësen Drita Ujupi në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.342-5/16 i datës 20.06.2017 për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë PP/II.nr.342-5/16 i datës 20.06.2017 për dhënien e urdhërit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me datë. 24.07.2017 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.342-5/16 i datës 20.06.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë:

## URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] me vendbanim në rrugën "[REDACTED]" në Ferizaj i lindur me datë [REDACTED] në Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] gjinisë [REDACTED] i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

## ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 07.03.2016 rreth orës 16:47 në rrugën magjistrale Prishtinë-Shkup përball NTP, [REDACTED] në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës "VW 70XOA" ngjyrë e kaltër me targa të regjistrimit [REDACTED] nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së ka rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes ashtu që nga pamundësia për ta ndalur prape automjetin në lëvizje para tij, me pjesën e përparme godet automjetin e markës "VW Golf" ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit [REDACTED] që ishte i ndalur në kolonë, të cilën e drejtonte [REDACTED], me ç'rast nga kjo goditje pos dëmit material në automjet, lëndime të

lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin pësojnë të dëmtuarat [REDACTED]  
dhe [REDACTED] të përshkruara si në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 05.06.2017,-

me të cilën ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,6,7,17,41,23,46 dhe 73 të KPK-së si dhe nenit 495, të KPP, të pandehurin e,

### G J Y K O N

Me dënim në gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është e obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rastë se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 47 të KPK-së, i njëjti do të zëvendësohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1(një) ditë burg.

Të dëmtuarat [REDACTED] nga fshati [REDACTED] omuna Ferizaj dhe [REDACTED] nga Kaçaniku për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 60.88 euro si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.342-5/16 i datës 20.06.2017 ka akuzuar të pandehurin [REDACTED] për vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhërit ndëshkues, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallximi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit [REDAKTUAR] i datës 11.06.2017, mendimi dhe konstatimi ekspertit të mjekësisë-ligjore Dr. [REDAKTUAR] i datës 05.06.2017,raporti mjekësorë nga Qendra Emergjente në Ferizaj të datës 07.03.2016 dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata në bazë të nenit 463 të KPP të dëmtuarat [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj dhe [REDAKTUAR] nga Kaçaniku për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në baze të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së dhe atë në emër të shpenzimeve penale te paguaj në shumën prej 60.88€, ndërsa në emër të paushallit gjyqësore shumen prej 20€.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-- Departamenti i Përgjithshëm –  
Divizioni Penal**

**P.nr. 1569/17, me datë 24.07.2017**

**Sekretare juridike**

Drita Ujupi



**Gjyqtari**

Mustaf Tahiri

**KESHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.